

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
MIDIS
INSTITUTIT ALBANOLOGJIK TË PRISHTINËS (IAP)
DHE
KOLEGJIT ' BIZNESI' -PRISHTINË

Dy titullarët, Prof. dr. Hysen Matoshi, në cilësinë e Drejtorit të Institutit Albanologjik të Prishtinës (në emër të IAP) dhe prof. Dr. Shyqeri Kabashi, në cilësinë e Dekanit të Kolegjit BIZNESI në Prishtinë (në emër të KB), duke pasur si nismë thellimin e marrëdhënieve nëpërmjet bashkëpunimit, janë marrë veshë:

Neni 1

Palët janë marrë vesh të bashkëndihmojnë në këmbimin e botimeve të të dy institucioneve, pasurimin dhe vënien në shërbim të përdoruesve fizikë dhe/ose në linjë/online të botimeve me interes për të dy institucionet.

Neni 2

Palët këmbëjnë botimet me interes për institucionet që përfaqësojnë duke marrë obligim që të ndihmojnë njëri-tjetrin kurdo që ka nevojë.

Neni 3

Palët ushtrojnë ndaj njëra tjetrës të drejtën e shkëmbimit të librave, gazetave, revistave, botimeve elektronike, CD-ROM-eve, mikrofilmave dhe çdo material tjetër të botuar nga këto dy institucione, me qëllim të ndihmesës së lexuesve dhe studiuesve të të dy institucioneve me botimet përkatëse, sidomos ato që janë pjesë e kujtesës kombëtare, por edhe e botimeve të tjera me interes për të dy palët.

Neni 4

Palët ushtrojnë ndaj njëra-tjetrës të drejtën e shkëmbimit të botimeve të tyre bibliografike, publicistike dhe shkencore.

Neni 5

Palët ndihmojnë njëra-tjetrën për transportimin e botimeve, sipas kushteve, kërkesave dhe mundësive të ndërsjella.

Neni 6

Palët bashkëpunojnë në fushën e kërkimeve të ndërsjella, varësisht nga mundësitë, si dhe përgatitjen e botimeve të përbashkëta.

Neni 7

Palët bashkëpunojnë në promovimin e botimeve të autorëve ose të studiuesve në fushat përkatëse.

Neni 8

Palët bashkëpunojnë në organizimi e ekspozitave, veprimtarive të përbashkëta kulturore e shkencore me karakter kombëtar.

Neni 9

Palët ndihmojnë në përrurimin e trashëgimisë kulturore kombëtare, varësisht nga mundësitë e të dy institucioneve edhe përmes rrjetit botëror të informacionit.

Neni 10

Marrëveshja nuk ka kufizime kohore.

Marrëveshja plotësohet dhe shtjellohet më tej me mirëkuptim të dyanshëm.

Ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqim të përbashkët.


Neni 11


Marrëveshja hyn në fuqi menjëherë.

Nënshkruhet në Prishtinë më 19.12.16 në dy kopje origjinale në shqip.

Për Institutin Albanologjik

Drejtori


Prof. dr. Hysen Matoshi



Për Kolegjin BIZNES

Dekani


Prof. Dr. Shyqeri Kabashi